REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN

DREJTORIA E LEJEVE, LICENCAVE DHE MONITORIMIT TË SHËRBIMEVE

Nr. 5054/2 Prot. Tiranë, më 30.06. 2026

Lënda: Dërgohet urdhri për njohje dhe zbatim

KOLEGJIT UNIVERSITAR "QIRIAZI"

Adresa: Rruga "Taulantet", Kodër-Kamëz, Tiranë 1029

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr. 23, Tiranë

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 219, Tiranë

Bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin nr. 280, datë 30.06.2026, të Ministrit të Arsimit, "*Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik, Sporte dhe Shëndet", në Kolegjin Universitar "Qiriazi"*".

Në raportin e vlerësimit të ekspertëve të jashtëm është lënë sugjerimi që IAL-ja të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave profesionale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E ARSIMIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
MINISTRI

Nr. 5054/1 Prot.

Tiranë, më 30.06.2026

URDHËR

NR. 280, DATË 30.06.2026

PËR

HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE NË "MËSUESI NË EDUKIM FIZIK, SPORTE DHE SHËNDET", NË KOLEGJIN UNIVERSITAR "QIRIAZI"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 75, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Mësuesi në Edukim Fizik, Sporte dhe Shëndet", me 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike (4 semestra), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kod 72MS0188S.
   Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë "Master i Shkencave" në "Mësuesi në Edukim Fizik, Sporte dhe Shëndet", në Fakultetin e Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit, në Kolegjin Universitar "Qiriazi", referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

2. Veprimtaria akademike në programin e studimit fillon sipas legjislacionit në fuqi.

3. Institucioni i arsimit të lartë, të marrë masa që programi i studimit t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Institucioni i arsimit të lartë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë institucionit përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

5. Ministria e Arsimit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin, në Ministrinë e Arsimit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, institucioni përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore dhe Kolegji Universitar "Qiriazi".

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

MIRELA KUMBARO-FURXHI

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 23, AL 1001, Tiranë E-mail: info@arsimi.gov.al www.arsimi.gov.al